Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 01/405
Datë: 20.08.2021

Në mbështetje të neneve 6 dhe 16 të Ligjit Nr.03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare, si dhe, Udhëzimit Administrativ të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) Nr.35-2014 për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve qe ofrojnë kualifikime ne Kosove, Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK), në mbledhjen e mbajtur me datë 20.08.2021 nxjerrë këtë:

V E N D I M

1. **Akreditohet institucioni** "UBT", me adresë: Lagjja Kalabria p.n, Prishtinë, Republika e Kosovës, për periudhën tre (3) vjeçare, përkatësisht nga data 01.09.2021 deri 31.08.2024, me kualifikimet e aprovuar në Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve (KKK).
   - 1.1 **TEKNIK I LABORATORIT MJEKËSOR,** Niveli III dhe IV sipas KKK, lloji: Kualifikim Kombëtar i Kombinuar (C) me 180 kredi të AAP. Institucioni mund të realizojë procesin e arsimit dhe aftësimit profesional me nga njëzetepesë (25) nxënës brenda një klase për orët e mësimit teorik, dhe gjatë një viti mund të mbahen deri në gjashtë (6) paralele. Ndërsa praktika profesionale realizohet me nga shtatë deri në tetë (7-8) nxënës brenda një grupi.
   - 1.2 **TEKNIK I FARMACISË,** Niveli III dhe IV sipas KKK, lloji: Kualifikim Kombëtar i Kombinuar (C) me 180 kredi të AAP. Institucioni mund të realizojë procesin e arsimit dhe aftësimit profesional me nga njëzetepesë (25) nxënës brenda një klase për orët e mësimit teorik, dhe gjatë një viti mund të mbahen deri në tre (3) paralele. Ndërsa praktika profesionale realizohet me nga tetë (8) nxënës brenda një grupi.
   - 1.3 **BASHKËPUNËTOR PROFESIONAL I INFERMIERISË,** Niveli III dhe IV sipas KKK, lloji: Kualifikim Kombëtar i Kombinuar (C) me 180 kredi të AAP. Institucioni mund të realizojë procesin e arsimit dhe aftësimit profesional me nga njëzetepesë (25) nxënës brenda një klase për orët e mësimit teorik, dhe gjatë një viti mund të mbahen deri në gjashtë (6)

paralele. Ndërsa praktika profesionale realizohet me nga gjashtë deri në tetë (6-8) nxënës brenda një grupi.

1.4 **ASISTENT DENTAR,** Niveli III dhe IV sipas KKK, lloji: Kualifikim Kombëtar i Kombinuar (C) me 180 kredi të AAP. Institucioni mund të realizojë procesin e arsimit dhe aftësimit profesional me nga njëzetepesë (25) nxënës brenda një klase, dhe gjatë një viti mund të mbahen deri në gjashtë (6) paralele.

2. **Ri-akreditohet KURSI I GJUHËS ANGLEZE Niveli A1-C1.** për periudhën tre (3) vjeçare, përkatësisht nga data 22.04.2021 deri 21.04.2024,. Institucioni mund të realizojë procesin e arsimit dhe aftësimit profesional deri në pesëmbëdhjetë (15) kandidatë brenda një grupi.

3. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m

Në bazë të kërkesës së institucioni "UBT", për validim, akreditim, ri-akreditim dhe rekomandimeve të dala nga Raporti i vlerësimit të ekipit të ekspertëve mbi validimin e kualifikimit, si dhe Raporti i ekipit të ekspertëve mbi akreditimin dhe ri-akreditimin e institucionit, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Rekomandimet përfundimtare të ekipit të ekspertëve janë të mbështetura në dëshmi dhe dokumente të ofruara nga institucioni në fazën e aplikimit: Aplikacionin për validim të kualifikimit/modulit; Aplikacionin për akreditim si institucion ofrues dhe/ose vlerësues dhe lëshues të kualifikimit; Raportin e Vetëvlerësimit; Vizitën në institucionin/ofruesin aplikues, si dhe dokumente tjera shtesë.

Pas trajtimit në detaje nga ekipi i ekspertëve të dokumentacionit të sipërpërmendur dhe të gjeturave nga vizita, ekipi i ekspertëve në raportin e hartuar dha vlerësim pozitiv, dhe të njëjtin ia rekomandoi Këshillit Drejtues për vendimmarrje. Mbi këtë bazë, Këshilli Drejtues, bazuar në kompetencat e tij, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 20, pikat 1, 2, 3 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ të MASHT për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë me Nr. 35/2014. Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet KD të AKK, në afat prej 15 ditësh pas lëshimit të vendimit.

Vendimi u dërgohet:

1. "UBT", dhe
2. Arkivit të AKK-së.

Prof. Dr. Agron BAJRAKTARI

Kryetar KD së AKK